



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosova

Komuna e Novobërdës

Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

Në bazë të nenit 67 dhe 68 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, Neni 8 paragrafi 2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dhe Neni 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Komuna e Novobërdës shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Titulli i vendit të punës:	Infermier/e në QMF, "Kufcë"-
Institucioni:	Komuna e Novobërdës
Departamenti/ Drejtoria:	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale-QKMF
Lloji i pozitës:	Nëpunës i Shërbimit Publik
Numri i pozitave:	(1)
Mbikqyrësi:	Drejtori i drejtorisë
Grada/Koeficienti:	H-377
Kohëzgjatja e emërimit:	Me kohë të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë për infermier/e

- Praktikon përputhjen me kodin etik dhe zbaton procesin e kujdesit infermieror të dokumentuar
- Reagon në mënyrë efektive për të papriturat ose ndryshon situatën në shpejtësi
- Komunikon në mënyrë efektive me individët, pacientët apo familjen dhe ofron kujdes të standartit të lartë dhe dokumenton punën e bërë
- Ofron promovim dhe edukim shëndetësorë për individin, pacientin dhe familjen në theks të veçantë në marrjen e përgjegjësisë.
- Inkurajohet nga punë ekipore nga mjeku familjar dhe mjeku i përgjithshëm
- Ofron shërbimet e kujdesit antental dhe post-natal, imunizimin dhe vaksinimin
- Përgatit dhomën e ekzaminimit me pajisje dhe furnizime të nevojshme të kërkuar për vizitë, gjithashtu asiston gjatë ekzaminimit të procedurave të kërkuara, si dhe administron terapin enterale dhe paranterale të përshkruara nga mjeku familjar
- Kryen edhe punë administrative dhe vepron në mënyrë profesionale dhe në përputhje me të gjitha rregulloret, procedurat dhe politikat e Ministrisë së Shëndetësisë në fuqi për KPSH-ën.
- Zbaton detyrat e deleguara nga menaxheri në pajtueshmëri me politikat shëndetësore në fuqi, gjithnjë duke e ruajtur konfidencialitetin profesional.

- Realizon veprimin e duhur dhe të sigurt, deponon dhe administron paisjet, barnat dhe të gjitha informatat klinike në mënyrë të duhur dhe me një kosto efektive.
- Zbaton protokollet e praktikave infermierore

Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve:

- Të ketë kryer shkollën e mesme të Mjekësisë
- Të ketë shkathtësi pune i/e pa varur në ekip
- Të ketë njohuri të punës në kompjuter
- Të ketë gatishmëri të punoj në të gjitha grupet, pa dallim: moshe, gjinie, kulture, etnie, religjioni apo race.

Dokumentet e nevojshme:

- Formulari i aplikimit i plotësuar
- Rezymeja personale (CV)
- Dokumenti personal (Leternjoftimi apo Pasaporta), fotokopje
- Diploma e kualifikimit
- Kopjet e Licensës
- Certifikata që nuk jeni nën hetime (Origjinali)
- Certifikata e Mjekut pas përzgjedhjes nga Komisioni

Dokumentat duhet të jenë në Kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen në rastin e intervistimit.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata të cilat do të jenë të dëshmuara (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Afati dhe mënyra e aplikimit:

konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit, aplikacionet dorëzohen nga data 27.02.202. deri më 13.03.2023.

Paraqitja e kërkesave:

Aplikacionet merren në zyrën nr 23 dhe 24 njësi e burimeve njerëzore , si dhe mund të shkarkohen nga Web-faqja zyrtare e Komunës së Novobërdës , ose nga <https://konkursi.rks-gov.net/> dhe të plotësuarat dorëzohen në zyrën e Personelit nr 24

Rezultatet shpallen në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/> -Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pa kompletuara nuk do të pranohen.

